

Akt Themelimi

i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

“SHERO” SH.P.K

Neni 1 Formimi

Sot në Durrës më datë 19.02.2025 themeluesi që firmosi si më poshtë:

1. **Flamur Tuda**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 01.02.1971 , lindur në Shotel, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. H10201010D.
2. **Sherif Tuda**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 08.08.2004 , lindur në Durrës, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. K40808007T.

Në bazë të Ligjit Nr.9901, dt.14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe Ligjit Nr.9723, dt.03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” themeloj me vullnetin tim të lirë Shoqërinë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin “SHERO” sh.p.k

Neni 2 Selia

Selia e shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “SHERO” sh.p.k është në adresën: Durrës, Pjeze, Zona Kadastrale 2978, Nr. Pasurie 63/6.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "SHERO" sh.p.k është pa afat nga momenti i regjistrimit të saj pranë QKB DURRES.

Neni 4

Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "SHERO" sh.p.k është:

1. Blerje dhe shitje e automjeteve dhe e mjeteve me motorr, Import/Eksport. Dhenie makina me qera.

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë "SHERO" sh.p.k është 100.000 lekë dhe i përbërë nga 2 kuot sipas kontributit të ortakëve si më poshtë:

1. **Flamur Tuda**, në masën 50% (Pesdhjet përqind)
2. **Sherif Tuda**, në masën 50% (Pesdhjet përqind)

Ky kapital do të ngurtësohet në bankë mbasi shoqëria të rregjistrohet në QKB

Kapitali fillestar është i nënshkruar dhe shlyer teresisht nga themeluesi, ai mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrin ortakët, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar. Do të ngurtësohet në bankë mbasi shoqëria të rregjistrohet në Q.K.B.

Neni 6

Organet e Shoqërisë dhe Asambleja

Organet drejtuese të shoqërisë "SHERO" sh.p.k janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendimmarrës.
- Administrator është z. **Flamur Tuda**.

- Kohëzgjatja e administratorit është 5 vjet.

Neni 7

Organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë, vendas apo të huaj, shprehen në Status që bashkë me Aktin e Themelimit janë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë shoqëri.

Neni 8

Veprimtarinë e saj shoqëria do ta zhvillojë në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 9

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, me anë të dispozitave të këtij akti, statuti si dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat atëherë zgjidhen me Gjykatë.

Ky akt themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "SHERO" sh.p.k në QKB në këtë ditë shoqëria "SHERO" sh.p.k njihet si person juridik.

Ortakët:

Flamur Tuda



Sherif Tuda

